

## **PROCESVERBAL**

nga mbledhja e nëntë e Komisionit për përmbajtjet programore në gjuhën shqipe dhe gjuhët e pjesëtarëve të popujve pakicë dhe bashkësive tjera nacionale.

Mbledhja e Komisionit u mbajt me 29 nëntor 2022

Në mbledhje morën pjesë:

1. Admir Adroviq, kryetar;
2. Veron Halili, anëtar;
3. Tripo Matijeviq, anëtar;
4. Ivana Krushçiq, anëtare;
5. Mirheta Garçeviq, anëtare

Frashër Selimaj, anëtar nuk mori pjesë në mbledhje për shkak të obligimeve të mëparshme, për ç'gjë e njoftoi kryetarin e Komisionit.

Krahas anëtarëve të Komisionit, në mbledhje mori pjesë edhe Ivan Lekoviç, sekretar i Komisionit.

Në mbledhje u miratua

### **RENDI I DITËS**

1. Diskutim dhe deklaram për Procesverbalin nga mbledhja e nëntë e Komisionit;
2. Analiza e përfaqësimit të popujve pakicë në të punësuarit në Servisin publik;
3. Të ndryshme.

#### **I**

Procesverbali nga mbledhja e tetë e Komisionit u miratua me votat e të gjithë anëtarëve prezent. (5 vota PËR)

#### **II**

Admir Adroviq si përfaqësues i Këshillit boshnjak theksoi se sipas regjistrit të të punësuarve në RTMZ nga 31 maji i vitit 2021, i cili është i shpallur në sajtin e RTMZ, nga 732 të punësuar, vetëm 17-18 sish janë me emra ose mbiemra mysliman, përafërsisht 2%, që është një e dhënë shumë dëshpëruese. Konkretisht, sipas njoftimeve të tij, vetëm dy nga ata deklarohen boshnjak. Nëse bëhet fjalë për Servisin publik, që RTMZ është, atëherë bëhet pyetja nëse pjesëtarët e këtij populli janë të paaftë apo është në pyetje diskriminimi. Problemi është i trashëguar nga periudha e mëparshme, mirëpo ende nuk ka farë ndryshimesh. Krahas kësaj ai konsideron se menaxhmenti i RTMZ duhet të investojë në shkollimin e kuadrit ekzistues, i cili sipas mendimit të tij, posedon potencial i cili duhet përmirësuar, e jo të sjellën gazetarë nga shtëpitë tjera mediatike.

Ivana Krushçiq është e mendimit se duhet patur kujdes që të përfaqësohen edhe si redaktor, udhëheqës, përfaqësuesit e të gjithë popujve pakicë dhe të bashkësive tjera.

Mirheta Garçeviq e prezantoi një të dhënë se në bazë të regjistrimit të të punësuarve, në Radion e MZ janë të punësuar 4,12%, kurse në Televizionin e MZ, pa kabinet, 2,25% të punësuar, të cilët kanë emër apo mbiemër mysliman. Nëse kihet parasysh e dhëna se në regjistrimin e fundit të popullsisë, kjo përqindje ishte 12,09%, ajo konsideron se numri i të punësuarve nuk do të duhej të jetë më pak se 10%. Gjithashtu, është e pajtimit me Admir Adroviq se është e pamundur se mungon kuadro profesionist. Ajo gjithashtu theksoi se kjo përqindje është më e ulët në sektorin e personelin teknik. Ajo tërheq vërejtjen se nuk e ka qëllimin që punësimi të bëhet me çelës nacional, por sipas kritereve që vlejné edhe për tjerët, por ekziston pakënaqësi e madhe me gjendjen ekzistuese.

Tripo Matijeviq theksoi se sipas njoftimeve të tij, vetëm një i punësuar është pjesëtar i popullit kroat. Në krahasim me regjistrimin e fundit të popullsisë, ky numër do të duhej të ishte më së paku 6-7 të punësuar.

### III

Admir Adroviq pyeti se çka ka ndodh me iniciativat të cilat i janë dërguar Këshillit të RTMZ. Ivan Lekoviq i njoftoi se iniciativat do të shqyrtohen në mbledhjen e parë të rregullt, e pastaj për rezultatet e tyre do të njoftohen anëtarët e Komisionit.

PROCESVERBALIN E  
Ivan Lekoviq

PUNOIKRYETARI I KOMISIONIT  
Admir Adroviq